



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 14, Datë 09.09.2015

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR “GODINË BANIMI DHE SHËRBIMESH
9 KAT MBI TOKË DHE 2 KAT PARKIM NËN TOKË” NË RRUGËN E KAVAJËS,
BASHKIA TIRANË

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, nenit 19, nenit 45, gërma “c” të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar, Vendimit Nr. 877, datë 03.10.2013 të Këshillit të Ministrave “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, si dhe Vendimit Nr. 7, datë 23.03.2015 të KKT-së “Për trajtimin e disa kërkesave për leje zhvillimi/ndërtimi të depozituara pranë bashkisë Tiranë përpara hyrjes në fuqi të Vendimit Nr.1, datë 22.08.2014, të KKT-së “Për harmonizimin e instrumenteve të planifikimit vendor në funksion të ndarjes së re administrativo-territoriale”, me kërkesë të Bashkisë Tiranë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për “Godinë banimi dhe shërbimesh 9 kat mbi tokë dhe 2 kat parkim nën tokë”, me vendndodhje në Rrugën e Kavajës, Bashkia Tiranë, me subjekt kërkuar “Park Konstruksion” sh.p.k.
2. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:
 - a. Dokumenti i Rregullores së Lejes së Ndërtimit;
 - b. Harta e Planvendosjes së Strukturës
3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban për lëshimin e Formularit të Lejes së Ndërtimit.
4. Formulari i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkuar vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për llogari të Njesisë së Qeverisjes Vendore.
5. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Urban dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

